



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA**  
**T I R A N E**

---

**Nr. 05 Akti**  
**Datë 22. 02. 2010**

**Nr. 04 Vendimi**  
**Datë 25. 02. 2010**

**V E N D I M**

**“PËR SEKUESTRON E PASURIVE”**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga :

**GJYQTAR : KLODIAN KURUSHI**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Jolanda NASUFI**, sot më datë 25. 02. 2010 mori në shqyrtim kërkesën me :

**KËRKUES :** Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Adnan XHOLI**.

**OBJEKTI :** Sekuestrim i pasurive të të pandehurit **A.H**,  
lindur dhe banues në Lushnje, i cili aktualisht ndodhet i paraburgosur, në ambientet e Institucionit të Paraburgimit, Rr.”Jordan Misja”, Tirane, akuzuar për veprat penale të *“Vrasjes me paramendim”* të shtetasit Xh.D, e parashikua si krim nga neni 78 i Kodit Penal, *“Mbajtjes pa leje të armes luftarake”*, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, *“Organizates kriminale”* dhe të *“Kryerjes të vepres penale nga organizata kriminale”*,

*parashikuar nga nenet 333 e 334 te K.Penal.*

**PERSONA TE TRETE:**      **1.G.H**, lindur dhe  
banues ne Lagja “xxxx” - Lushnje.

**2.T.H**,lindur dhe  
banues ne Lagja “xxxx” -Lushnje.

**BAZA LIGJORE:**      Ligji nr. 10 192, datë 03. 12. 2009 , “Për  
parandalimin dhe goditjen e krimit të  
organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave  
parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të seancës gjyqësore përfaqësuesi i prokurorisë kërkoi:

Pranimin e kërkesës në të gjithë objektin e saj.

Gjykata pasi shqyrtoi në seancë paraprake me praninë e prokurorit kërkesën e paraqitur prej tij, pasi administroi provat e shqyrtuara ne këtë gjykim, si dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi

### **V Ë R E N**

Në datën **18. 09. 2006**, i pandehuri A.H është akuzuar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, për kryerjen e veprave penale të mëposhtme;

*“Vrasjes me paramendim” të shtetasit XH.D, parashikuar si krim nga neni 78 i Kodit Penal;*

*“Mbajtjes pa leje të armës luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.*

*“Organizatës kriminale” dhe te “Kryerjes të veprës penale nga organizata kriminale”, parashikuar nga nenet 333 e 334 te K.Penal.*

Në datën **17.04.2007**, Prokuroria per Krime te Renda-Tirane, ka dërguar për gjykim çështjen në ngarkim të të pandehurit A.H dhe të 7 të pandehurve të tjerë dhe aktualisht kjo çështje është ende në fazën e gjykimin në Gjykatën e Shallës së Parë

për Krime të Rënda -Tiranë, ku i pandehuri **A.H**, po gjykohet për veprat penale për të cilat dhe është akuzuar.

**Më datë 03. 08. 1997 në qytetin e Lushnjës, është vrarë me armë zjarri shtetasi shqiptaro-maqedonas XH.D.** Në hyrje të qytetit të Lushnjës viktimat së bashku me familjarë të tij janë ndaluar nga katër persona të armatosur, ku ndërmjet tyre kanë qenë të pandehurit **A.H** dhe **I.S.** Pasi kanë vënë maskat në kokë ata kanë qëlluar në drejtim të shtetasit **XH.D**, i cili kishte zbritur nga furgoni, duke i shkaktuar atij vdekjen. Ndërkohe i pandehuri **A.B**, i cili ka qenë në një autoveturë afër vendit të ngjarjes është afruar me shpejtësi dhe në autoveturë kanë hyrur të gjithë personat e sipërcituar.

Të gjithë viktimat për të cilët është akuzuar i pandehuri **AH** dhe të pandehurit e tjerë, kanë qenë shokë, miq të shtetasit të vrarë **AD**, i cili ishte kundërshtari i personit që dyshohet si drejtues i organizates kriminale **AD**.

**Si moment i krimit të organizates, e ashtequajtura “Bande e Lushnjës” apo “Grupi i A.SH” është vrasja dhe dhunimi i kufomës të shtetasit R.SH, vëllai i të pandehurit A.B, në muajin korrik të vitit 1997 në qytetin e Lushnjës.** Kjo vrasje dyshohet se ka ardhur si pasojë e përballjes me bandën e shtetasit **A.D**, banor i qytetit të Lushnjës. Pas vrasjes shtetasi **A.B**, me qëllim hakmarrjen ndaj shtetasit **A.D** dhe pjestarëve të bandës, krijoi bandën e tij.

Sa parashtroam më sipër,

Rezulton se i pandehuri **A.H**, është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”**, (neni 3/1 germa “a”). Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë ka filluar hetimin pasuror për pasuritë e fituara nga i pandehuri **A.H** si dhe të afërmit e tij.

**Nga hetimi pasuror, ka rezultuar se i pandehuri A.H dhe familjarët e tij disponojnë pasuritë e mëposhtme:**

- 1- Apartament me sipërfaqe 75 m2, në pronësi të shtetasit G.SH.H, regjistruar në pasurinë me nr. xxxx, Vol x, faqe xxx, Zona Kadastrale nr. xxxx Lushnjë. Ky apartament është blerë në datë 10/05/1996 nga G.H (vëllai i të pandehurit), në shumën prej 850.000 (teteqinde e pesdhjetemije) leke, sipas kontratës me nr.950, të lidhur me shtetasit I.L, M.L dhe M.L,**

- 2- **Pasuria truall + ndërtesë, me sipërfaqje totale 200 m<sup>2</sup>, e regjistruar me nr. xxxx, Zona Kadastrale nr. xxxx, Lushnjë. Kjo pasuri i është blere shtetasit D.B, nga ana e shtetasit SH.H ne daten 22/11/2000, sipas kontrates me nr. xxxx Rep, ne shumen 1.900.000 leke. Aktualisht ky objekt, pas vdekjes se te ndjerit SH.H (ne date 22/07/2003), sipas kontrates se shitblerjes me nr.xxxx Rep dhe 633 Kol, date 06/10/2003, ka kaluar në bashkëpronësi të të pandehurit **A.H** dhe vëllait të tij **G.H**, te cilet kane paguar shumen prej 1.000.000 (njemilione) leke**
- 3- **Apartament “A”, me sipërfaqe 132.95 m<sup>2</sup>, kati i shtatë, i përbërë nga tre dhoma një guzhinë, dy banjo, koridor, dy ballkone si dhe nje garazhd, te cilet ndodhen në kryqëzimin e rrugëve “xxxx” dhe “xxxx”, Tiranë, regjistruar në pasurine me nr.xxxx zona kadastrale n rxxx, Regjistri x, Numri rendor x, datë 24.09.2003, indeksi i hartes TR-R-11, në pronësi të të pandehurit **A.H**. Pasuri te cilat i pandehuri **i ka blere ne daten 16/09/2009**, nga shtetasit E.M dhe S.H, sipas kontrates me nr.4260 Rep dhe 237 Kol, **ne shumen prej 4.500.000 (katemilione e peseqindemije) leke. Shume e cila është likjuar teresisht.****
- 4- **Pasuri me sipërfaqe totale 110 m<sup>2</sup> truall, dhe mbi këtë truall është ndërtuar një Lokal “Pastiçeri” me sip.108 m<sup>2</sup>, me vendodhje Zona Kadastrale nr xxx, nr. i Pasurisë xxx, fleta nr.xxx indeksi -Lushnje. Pasuri e cila është regjistruar ne emer te shtetasit **G.H** dhe e ka blere nga seksioni i finances se keshillit te rrethit Lushnje, sipas kontrates me nr.xxx Rep, xxx Kol, datë 14/09/2000, në shumën 72.900 (shtetehjete e dymije e nënteqind) lekë.**
- 5- **Motorçiklete YAMAHA, prodhim i vitit 2002, me targa xxxxx, në pronësi të të pandehurit **A.H**, sipas kontrates me nr.xxxx Rep, date 04/06/2004, e blerë në shumën prej 110.000 lekë.**
- 6- **Automjet Autoveturë, Marka MITSUBISHI-PAJERO, prodhim i vitit 1999, me targa xxxx në pronësi të të pandehurit **A.H**, blerë në vitin 2001, sipas kontratës me nr. xxx Rregj, xxx kol,**
- 7- **Mjeti KAMION, marka SAURER, prodhim i vitit 1982, me targa xxxx, në pronësi të shtetasit **G.H**. Ky mjet është blerë nga shtetasi **G.H**, më datë 02/12/2002, sipas kontratës me nr.8710 Rep dhe 3644 kol, në shumën 250.000 lekë.**

8- Mjeti AUTOVETURE, marka BENZ, prodhim i vitit 1989, me targa xxxx, në pronësi të shtetasit T.SH.H, sipas kontratës me nr. xxx, rep dhe xx kol, datë 20/01/2005, i blerë në shumën prej 250.000 lekësh.

9- Llogari bankare pranë BKT – Lushnjë, me nr. xxxx, e celur në emër të të pandehurit Afrim Shefqet Hoxha, në shumën 1,148. 81 Euro,

Gjykata vlerëson se i pandehuri A.H dhe familjaret e tij që janë shtetasit G.Sh.H dhe T.Sh.H disponojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Në të tilla rrethana, bazuar dhe në nenin 3/2 të Ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, rezulton se i pandehuri dhe familjaret e tij janë subjekte të këtij ligji, ndaj dhe pasuritë e tyre duhet që ti nënshtrohen procedurës së sekuestrimit sipas nenit 11 të ligjit të mësipërm.

Pasuritë janë të regjistruara në emrin e të pandehurit dhe familjarëve të tij. Ky fakt, si dhe fakti që familjaret e të pandehurit janë të lirë, përbejne një rrezik real dhe potencial që pasuritë e mësipërme të tjetërsohen, apo të humbasin (neni 11/a). Gjithashtu, gjykata konstaton se pasuritë e mësipërme janë krijuar pas datës 03. 08. 1997, kohë në të cilën është ka filluar aktivitetin kriminal i pandehuri A.H.

Përjashtim nga kjo periudhë, bën vetëm **apartamenti me sipërfaqe 75 m2, në pronësi të shtetasit G.Sh.H**, regjistruar në pasurinë me nr. xxxx, Zona Kadastrale nr. xxxx, Lushnjë, pasi ky apartament **është blerë në datë 10. 05. 1996** nga shtetasi G.H, në shumën prej 850.000 (tetëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, sipas kontratës me nr. xxx, të lidhur me shtetasit I.L, M.L dhe M.L, ndaj dhe kjo pasuri, meqenëse është krijuar para periudhës që i pandehuri A.H, dyshohet se u përfshi në veprimtari kriminale sipas këtij ligji, nuk do ti nënshtrohet sekuestrimit pasuror.

Ndersa për gjithë pasuritë e tjera të përmendura më lart, do ti nënshtrohen procedurës së sekuestrimit, pasi ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme se këto pasuri janë krijuar pas periudhës së përfshirjes së të pandehurit në veprimtari kriminale sipas nenit 3/1 germa “a” të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **“Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”**.

Provat që ju nënshtrohen shqyrtimit të kërkesës në seancë gjyqësore dhe që e përlligjin kërkesën e paraqitur nga prokuroria janë:

- Informacion lidhur me pasuritë e të pandehurit A.H dhe familjarëve të tij, datë 01. 11. 2009,
- Vendim i datës 01. 11. 2009, për regjistrimin e procedimit pasuror,

- *Vendim i datës 07. 02. 2006, për regjistrimin e procedimit penal ku është bërë dhe regjistrimi i emrit të shtetasit A.H në regjistrin e veprave penale,*
- *Vendim i datës 17.04.2007, për ndarjen e procedimit penal nr. x në procedimet penale nr. x dhe xxx,*
- *Vendim i datës 18. 09. 2006, për njoftimin e akuzës së shtetasit A.H.*
- *Kërkesë për gjykimin procedimit penal nr. xxx të vitit 2007, datë 17/04/2007,*
- *Shkresa me xxx datë 24. 02. 2006 e ZVRPP - Lushnjë, lidhur me pasuritë që disponojnë i pandehuri dhe familjarët e tij,*
- *Shkresat me nr. xxx datë 27. 07. 2006 dhe xxx Prot, datë 24. 11. 2009, te ZVRPP Tiranë, lidhur me pasuritë që disponojnë i pandehuri dhe familjarët e tij, së bashku me dokumentacionin përkatës (formular aplikimi i datës 23. 09. 2003, mandat arkëtimi pranë bankës CBG, datë 22. 09. 2003, kontratë shitblerje me nr.xxxx Rep dhe xxx Kol, datë 16.09.2003, vërtetim hipotekor i datës 01. 09. 2003 së bashku me skicën dhe planimetrinë përkatëse,*
- *Shkresa me nr. xxx Prot, datë 10. 07. 2006 e ZVRPP-Tiranë, së bashku me kartelën e datës 30/06/2006 të apartamentit me sip.132.95 m2, në emër të A.H,*
- *Vërtetimi i datës 28. 03. 2006 e Degës së Tatim Taksave-Lushnje, së bashku me gjithë dokumentacionin për regjistrimin si person Juridik të shtetasve G.H dhe A.H, statuti i shoqërisë “xxx”, certifikata e regjistrimit në organin tatimor të shtetasit G.H me NIPT Jxxxxxxx, Kod Fiskal xxxx, Akti i themelimit të shoqërisë “xxx”shpk,*
- *Shkresa nr. xxx datë 08. 03. 2006 i Bankës Kombëtare Tregtare Dega Lushnjë lidhur me një llogari bankare me nr, xxxxx, në emër të të pandehurit A.H dhe të shtetasit T.H, në shumën 1.148.81 Euro, se bashku me pasqyrën përkatëse të llogarisë bankare,*
- *Procesverbali i datës 09. 02. 2010 për këqyrjen dhe marrjen e provave, konkretisht regjistrin të pasurive të palujtshme Lushnjë dhe praktikave të regjistrimit të pronave në emër të të pandehurit A.SH.H dhe të familjareve të tij.*
- *Shkresat me nr.xxx, datë 14. 02. 2006 dhe nr.7969/1 datë 20. 11. 2009, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, lidhur me mjete në pronësi të të pandehurit A.H dhe familjarëve të tij, së bashku dhe me kopje të dosjeve të këtyre automjeteve,*
- *Vendimi i datës 15. 02. 2010, për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve, së bashku me procesverbali për marrjen e dokumenteve i datës 17. 02. 2010, si dhe dokumentacioni shoqëruar për dosjet përkatëse të automjeteve me targa xxxxx, xxxxx, xxxxx,*
- *Shkresa me nr.xxxx/x Prot, datë 03. 12. 2009 e ALUIZNIT-Tiranë,*
- *Si dhe në tërësi, aktet e fashikullit të procedimit penal dhe pasuror.*

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet; 3, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”

## V E N D O S I

### • Sekuestrimin e pasurive të mëposhtme:

- 1. Truall + ndërtesë, me sipërfaqje totale 200 m2**, e regjistruar me nr. xxxx, Zona Kadastrale nr xxxx, lagja xxxx-Lushnjë. Ky objekt, sipas kontrates se shitblerjes me nr.xxxx Rep dhe xxx Kol, date 06/10/2003, ka kaluar në bashkëpronësi të të pandehurit **A.SH.H** dhe **G.Sh.H**.
- 2. Apartament banimi “A”, me sipërfaqe 132.95 m2**, kati i shtatë, i përbërë nga tre dhoma një guzhinë, dy banjo, koridor, dy ballkone **si dhe një garazh**, e cila ndodhet në kryqëzimin e rrugëve “xxxx” dhe “xxxx”, Tiranë, regjistruar në pasurine me nr.xxxx, zona kadastrale nr. xxxx, Regjistri xxx, Numri rendor xxx, datë 24.09.2003, indeksi i hartes TR-R-11, **në pronësi të të pandehurit A.SH.H**, pasuri që i pandehuri **i ka blerë në datë 16/09/2009.**
- 3. Pasurisë me sipërfaqe totale 110 m2 truall, dhe mbi këtë truall është ndërtuar një Lokal “Pastiçeri” me sip.108 m2** , me vendodhje Zona Kadastrale nr. XXXX, nr. i Pasurisë XXX, fleta nr.XXX indeksi, lagja XXX -Lushnje. Pasuri e cila është regjistruar në emër të shtetasit **G.SH.H** dhe e ka blerë nga seksioni i financës së Këshillit të rrethit Lushnje, sipas kontratës me nr. XXX Rep, XXX Kol, **datë 14/09/2000.**
- 4. Motorçikletë YAMAHA**, me nr. shasie JYAXXXX44YM, prodhim i vitit 2002, me targa **XXXX**, në pronësi të të pandehurit **A.SH.H**, e blerë në datë 04/06/2004, sipas kontratës me nr. XXX Rep.
5. Automjetit tip Autoveture, Marka MITSUBISHI-PAJERO, prodhim i vitit 1999, me nr, shasie JxxxxxJ000856, me targa **xxxx** në pronësi të të pandehurit **A.SH.H**, **blerë në vitin 2001, sipas kontratës me nr. xxx Rregj, xxxx kol,**
6. Mjetit KAMION, marka SAURER me nr. Shasie xxxx, prodhim i vitit 1982, me targa **xxxxx**, në pronësi të shtetasit **G.SH.H**. **Ky mjet eshte blere nga shtetasi G.H, me datë 02/12/2002, sipas kontratës me nr. xxx Rep dhe xxxx kol.**

7. Mjeti AUTOVETURE, marka BENZ, me nr. shasie EDxxxxxxx, prodhim i vitit 1989, me targa xxxx, në pronësi të shtetasit **T.SH.H**, sipas kontratës me nr. xxx, rep dhe xx kol, datë 20/01/2005.
8. Llogarisë bankare pranë BKT – Lushnjë, me nr xxxxx, e çelur në emër të të pandehurit A.SH.H, në shumën **1, 148. 81 Euro**,

Ngarkohen zyrat e përmbarimit të rretheve Tiranë dhe Lushnje të ekzekutojnë këtë vendim.

Ngarkohet administratori **A.H** në Agjensinë për Administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara në Ministrinë e Financave Tiranë *të administrojë pasuritë e paluajtshme* të sekuestruara më lart.

Ngarkohet administratori **I.D** në Agjensinë për Administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara në Ministrinë e Financave Tiranë *të administrojë pasuritë e luajtshme* të sekuestruara më lart.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit “Për Krimet e Rënda” Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij për palën e pranishme dhe nga dita e njoftimit të këtij vendimi të pandehurit dhe palës së interesuar.

*U shpall në Tiranë më datë 25. 02. 2010.*

**SEKRETARE**

**Jolanda NASUFI**

**GJYQTAR**

**Klodian KURUSHI**